



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

#### Rektori

Nr. 2650 Prot

Shkodër, më 05. 10 .2020

#### URDHËR

Nr. 308, datë 05. 10 . 2020

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM 436, datë 3.06.2020 "Për caktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimit në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e IAL-ve, për vitin akademik 202-2021 dhe 2021-2022 e në vijim"; Udhëzimit nr 10. datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë"; Urdhërave të përbashkët të RASH dhe QSHA me Nr.2, datë 02.07.2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021" dhe nr.4, datë 30.09.2020;

#### URDHËROJ

1. Të ndiqen procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, transferimet dhe programet e dyta të studimeve në USH për vitin akademik 2020-2021, nga personat përgjegjës sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Zv/Rektori, Dekanët, Drejtorët e Departamenteve, Drejtoria e kurrikulave, kërkimit shkencor dhe standarteve, Drejtoria e IT-së dhe Sekretariteti mësimor.
3. Të njihen të gjithë personat përgjegjës me VKM 436, datë 3.06.2020 "Për caktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimit në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e IAL-ve, për vitin akademik 202-2021 dhe 2021-2022 e në vijim"; Udhëzimin me Nr.10, date.15.05.2019 dhe Urdhërat e përbashkët të QSHA dhe RASH me Nr.2, date. 02.07.2020, dhe nr. 4, datë 30.09.2020.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





### Aneksi 1. Aplikimet dhe regjistrimet për vitin 2020-2021

#### A) Transferimet dhe programet e dyta të studimit për ciklin e parë të studimeve.

Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të parë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-së në datat: **22.10.2020 – 04.11.2020.**

Nr.	Procedura	Afartet dhe datat e realizimit	Personi/at përgjegjës
1	Aplikimi	22.10.2020 – 04.11.2020	Sekretaret e dekanëve
2	Shpallja e listave të kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi	06.11.2020	Dekanët e fakulteteve Sekretaret e dekanëve Drejtoria e IT
3			Dekanët e fakulteteve Departamentet Komisionet përkatëse
4	Shqyrtimi i dosjeve të aplikanteve nga komisioni	10.11.2020	Dekanët e fakulteteve Departamentet Komisionet përkatëse
5	Publikimi i listës së kandidatëve	11.11.2020	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
6	Shpallja e listës përfundimtare me renditjen e kandidatëve	13.11.2020	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
7	Regjistrimi i kandidatëve fitues	16.11.2020 – 20.11.2020	Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT
8	Plotësimi i kuotave të paplotësuara (ulja e vijës)	25.11.2020	Dekanët e fakulteteve Sekretaritetë mësimore
	Dërgimi i listave të studentëve të regjistruar në QSHA	15.12.2020	Dekanët e fakulteteve Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT

**B) Pranimet në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”**

Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, për të gjithë kategoritë e studentëve bëhen pranë sekretarive të fakulteteve, në IAL: **06.10.2020 - 06.11.2020.**

Nr.	Procedura	Afatet dhe datat e realizimit	Person/at përgjegjës
1	Aplikimi	<b>06.10.2020 - 06.11.2020</b>	Sekretaret e dekanëve
2	Shpallja e aplikantëve fitues (në vende të dukshme në fakultete dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL-së) të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikanti, në përputhje me kuotat e miratuara nga IAL.	<b>14.11.2020</b>	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
3	Ngarkohen listat në portalin U-albania	<b>14.11.2020</b>	Drejtoria e IT
4	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues nga portali U-albania.	<b>16.11.2020 deri 26.11.2020</b>	Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT
5	Shpallja e listave emërore të kandidatëve të regjistruar (në vende të dukshme në fakultete dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL-së)	<b>27.11.2020</b>	Dekanët e fakulteteve Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT
6	Dërgimi i listave të studentëve të regjistruar në QSHA	<b>29.12.2020</b>	Dekanët e fakulteteve Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT



**C. Program i dytë studimi apo transferim në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”**

Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave” kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve në datat : **22.10.2020 – 04.11.2020.**

<b>Nr.</b>	<b>Procedura</b>	<b>Afati dhe datat e realizimit</b>	<b>Personiat përgjegjës</b>
1	Aplikimi	22.10.2020 – 04.11.2020	Sekretaret e dekanëve
2	Shpallja e listës së aplikantëve (në vende të dukshme në fakultete dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL-së) që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi.	06.11.2020	Dekanët e fakulteteve Sekretaret e dekanëve Drejtoria e IT
3	Shqyrtimi i dosjes së kandidatëve	10.11.2020	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse
4	Shpallja e aplikantëve fitues (në vende të dukshme në fakultete dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL-së) të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikanti, në përputhje me kuotat e miratuara nga IAL.	11.11.2020	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
5			Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
6	Shpallja e listave përfundimtare me renditjen e kandidatëve	13.11.2020	Dekanët e fakulteteve Drejtoria e IT
7	Regjistrimi i kandidatëve	16.11.2020 – 20.11.2020	Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT
8	Plotësimi i kuotave të paplotësuara (ulja e vijës)	25.11.2020	Dekanët e fakulteteve Sekretaritetë mësimore
	Dërgimi i listave të studentëve të regjistruar në QSHA	29.12.2020	Dekanët e fakulteteve Sekretaritetë mësimore Drejtoria e IT